



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**KODI ETIK I SJELLJES**

**PËR STAFIN E ADMINISTRATËS DHE TË  
NJËSISË SË SHËRBIMIT LIGJOR, TË  
KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

**Tiranë, më 25.11.2019**

Në mbështetje të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, aktet nënligjore që rregullojnë çështjet të etikës, si dhe bazuar në standardet më të larta të etikës dhe integritetit të punonjësve, hartohet ky Kod mbi etikën dhe sjelljen profesionale të personelit administrativ dhe të këshilltarëve të njësisë së shërbimit ligjor të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

## **KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 1 Qëllimi**

Kodi Etik i Sjelljes ka për qëllim të përcaktojë parimet dhe rregullat etike të sjelljes së stafit të administratës dhe të njësisë së shërbimit ligjor, në përputhje me standardet më të larta profesionale të punës, të garantojë integritet të lartë profesional, paanshmëri dhe pavarësi në ushtrimin e funksionit publik dhe në zbatim të detyrave e përgjegjësive, që burojnë nga ligji nr. 84/2016 dhe kuadri ligjor e nënligjor në fuqi.

### **Neni 2 Fusha e veprimit**

1. Përveç/përyjashtimisht anëtarëve të Komisionit, parimet dhe rregullat e përcaktuara në këtë Kod janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjithë punonjësit e administratës së Komisionit dhe këshilltarët e njësisë së shërbimit ligjor (më tej “punonjësit e Komisionit”), pavarësisht funksionit dhe pozicionit të tyre në shkallë hierarkie.

2. Çdo punonjës i Komisionit duhet të jetë në gjendje që të tregojë, në çdo kohë, se veprimet dhe sjelljet e tij janë në pajtim me këtë Kod. Në kryerjen e funksionit dhe detyrave të tij, çdo punonjës respekton dhe zbaton me korrektësi ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, urdhrat dhe udhëzimet e brendshme, duke dëshmuar në këtë mënyrë integritet të lartë moral dhe profesional, në funksion të plotë të ruajtjes së reputacionit, integritetit dhe imazhit të institucionit, dhe të rritjes së besimit të publikut te sistemi i ri i drejtësisë.

### **Neni 3 Parime të përgjithshme**

1. Punonjësi i Komisionit kryen veprimtarinë e tij në përputhje me:

- a) parimin e ligjshmërisë;
- b) parimin e përgjegjshmërisë;
- c) parimin e integritetit;
- ç) parimin e profesionalizmit dhe të kujdesit të duhur;
- d) parimin e objektivitetit, pavarësisë, sjelljes së paanshme;
- dh) parimin e konfidencialitetit; dhe

- e) parimin e eliminimit të konfliktit të interesit.
2. Punonjësi duhet të jetë objektiv, i pavarur, i paanshëm, i kujdesshëm në dhënien e mendimeve në mënyrë publike mbi informacionin që zotëron, për shkak të funksionit që ushtron, kontrollues ose jo.
  3. Punonjësi duhet të jetë i ndershëm dhe i përkushtuar në kryerjen e detyrës së tij, duke pasur parasysh vetëm interesin publik të institucionit dhe në përputhje me misionin e Komisionit, të parashikuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr. 84/2016.

#### **Neni 4** **Parimi i ligjshmërisë**

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij punonjësi i Komisionit duhet të respektojë ligjin dhe të kryejë detyrat në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 5** **Parimi i përgjegjshmërisë**

1. Punonjësi i Komisionit duhet të ushtrojë veprimtarinë e tij në mënyrë të përgjegjshme dhe në përputhje me ligjin, pasi përgjegjësia personale në bazë të ligjit dhe rregulloreve në fuqi passjell, përveç përgjegjësisë administrative, edhe përgjegjësi penale.
2. Çdo punonjës i Komisionit e konsideron veten të përgjegjshëm në përputhje me funksionin ose detyrën që kryen dhe duhet të ketë aftësinë të jetë i kuptueshëm, i besueshëm, i hapur dhe transparent në marrëdhënie me eprorët dhe kolegët.
3. Çdo punonjës i Komisionit, në kryerjen dhe përmbushjen e detyrave me profesionalizëm, zbaton njohuritë, aftësitë dhe eksperiencën e duhur profesionale në funksion të detyrave dhe përgjegjësisë që burojnë nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, që normojnë gjithë veprimtarinë shtetërore dhe atë administrative të institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

#### **Neni 6** **Parimi i integritetit**

1. Punonjësi i Komisionit duhet të jetë i drejtpërdrejtë dhe i ndershëm në të gjitha marrëdhëniet e tij profesionale.
2. Punonjësi i Komisionit nuk duhet të marrë në konsideratë dhe të përfshihet në raportet, komunikimet apo informacionet e tjera, kur krijon bindjen se këto informacione:
  - a) përmbajnë deklarime të pavërteta ose deklarime të cilat nuk pasqyrojnë në mënyrë korrekte realitetin e fakteve;
  - b) përmbajnë informacione në lidhje me procedurën, për të cilat nuk është verifikuar saktësia e tyre;
  - c) nuk përfshijnë, me qëllim, të gjitha të dhënat dhe faktet e kërkuara për të paraqitur një raportim sa më të saktë.

3. Punonjësi i Komisionit, i cili i merr në konsideratë të dhënat e mësipërme, por krahas tyre paraqet një raport të veçantë shpjegues, nuk konsiderohet të ketë shkelur parimin e integritetit.

## **Neni 7**

### **Parimi i profesionalizmit dhe i kujdesit të duhur**

1. Punonjësi i Komisionit duhet të përmirësojë në vazhdimësi aftësitë e tij profesionale, nëpërmjet rritjes individuale profesionale, trajnimeve, konferencave dhe aktiviteteve të tjera të organizuara nga Komisioni ose nga institucione/agjenci publike apo private, të akredituara sipas ligjit.
2. Bazuar në parimin e profesionalizmit dhe të kujdesit të duhur, çdo punonjës duhet:
  - a) të zotërojë njohuri dhe aftësi në nivelin që kërkohet për detyrën dhe funksionin që ushtron, duke garantuar cilësi dhe standard të lartë profesional pune, në raport jo vetëm me eprorët, por edhe me kolegët;
  - b) të veprojë me kujdes dhe në përputhje me standardet ligjore që institucioni i rivlerësimit zbaton përgjatë procesit të rivlerësimit kalimtar të subjekteve të ligjit nr. 84/2016.
3. Punonjësi i Komisionit duhet të respektojë ligjet dhe rregullat e vendosura dhe të mënjanojë çdo veprim që cenon integritetin e tij profesional.
4. Punonjësi i Komisionit nuk duhet të përfshihet në veprimtari që i kompromentojnë aftësinë për të kryer detyrat profesionale, ose që rrezikojnë integritetin e tij personal.
5. Punonjësi i Komisionit duhet të deklarojë shërbimet që është në gjendje të ofrojë dhe të sigurojë informacione të sakta, bazuar në kompetencën e tij profesionale.
6. Punonjësi i Komisionit nuk duhet të bëjë referenca të padrejta ose të pavërteta për punën e punonjësve të tjerë të Komisionit.

## **Neni 8**

### **Parimi i objektivitetit, pavarësisë dhe sjelljes së paanshme**

1. Punonjësi i Komisionit duhet të jetë i ndershëm, objektiv, i pavarur dhe i paanshëm gjatë kryerjes së detyrës së tij zyrtare.
2. Punonjësi i Komisionit, gjatë realizimit të detyrave të ngarkuara, duhet të mbështetet në ligj për mbledhjen, vlerësimin, përpunimin dhe komunikimin e informacioneve dhe raportimeve me shkrim për eprorin/kolegët, me profesionalizëm, pa u ndikuar nga interesi i tij ose i të tjerëve.
3. Ndershmëria është një element bazë për të arritur sukses dhe për të pasur gjykim dhe vlerësim të drejtë. Punonjësi i Komisionit duhet të aplikojë parimet e barazisë, të drejtësisë dhe të moralit në realizimin e detyrave, duke parandaluar çdo sjellje që ka të bëjë me akte korruptive dhe shpërdorim të detyrës.
4. Në ushtrimin e funksioneve të tij, punonjësi duhet të marrë masa të mbrojtje pavarësinë e tij nga ndikime të brendshme apo të jashtme.

5. Në asnjë rast dhe për asnjë arsye, punonjësi nuk duhet të pranojë udhëzime apo sugjerime lidhur me performancën e detyrave të tij zyrtare, nga asnjë burim/person tjetër, përveç institucionit ku ushtron funksionin e tij/saj dhe të eprorit e titullarit të Komisionit.

6. Në çdo rast, mendimet, sugjerimet, propozimet, konkluzionet dhe vendimmarrjet, duhet të jenë ngushtësisht të lidhura vetëm me qëllimin e funksionit që kryen punonjësi, dhe në asnjë rast në tejkallim të këtij qëllimi.

7. Punonjësi i Komisionit respekton dinjitetin e çdo personi, pa diskriminim dhe paragjykimin ndaj përkatësisë etnike dhe kombësisë, përkatësisë shoqërore, pasurisë, moshës, paaftësisë fizike, besimit fetar, gjinisë, pikëpamjeve politike, orientimit seksual apo çdo gjendje tjetër, e cila përbën shkak për paragjyqime dhe trajtim të njëanshëm.

## **Neni 9**

### **Parimi i konfidencialitetit**

1. Punonjësi i Komisionit, pas marrjes në dorëzim dhe në disponim të dokumenteve të subjekteve, mund të ndeshet me të dhëna personale dhe konfidenciale. Ai duhet t'i përdorë ato vetëm për qëllime profesionale dhe vetëm nëse i nevojiten për realizimin e detyrave funksionale në zbatim të urdhrave/udhëzimeve të eprorit/eprorëve direkt, në respekt të plotë me shkallën e hierarkisë dhe nën autoritetin e titullarit të Komisionit.

2. Punonjësi i Komisionit respekton vlerën e informacionit që disponon sipas ligjit për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror" dhe në asnjë rast apo rrethanë nuk duhet t'i japë personave të tjerë brenda dhe jashtë institucionit, për asnjë arsye, informacionin që disponon, përveç rasteve kur autorizohet shprehimisht nga titullari i Komisionit. Shkelja e kësaj dispozite, pavarësisht parashikimit në ligjin penal, përbën shkelje të rëndë disiplinore dhe passjell pasoja për punonjësin.

3. Punonjësi i Komisionit duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për t'u siguruar që personeli që është nën kontrollin e tij dhe personat prej të cilëve janë marrë këshilla dhe ndihmë, të respektojnë detyrimin për të ruajtur konfidencialitetin.

4. Punonjësi i Komisionit është përgjegjës për parandalimin dhe marrjen e masave për mbrojtjen e informacionit të brendshëm të institucionit. Në asnjë rast, për shkak të funksionit që kryen, punonjësi nuk duhet të përdorë apo keqpërdorë informacionin që disponon, në tejkallim të qëllimit për të cilin është vënë në dijeni.

5. Çdo punonjës i Komisionit gëzon lirinë e opinionit profesional dhe personal gjatë ushtrimit të detyrës, duke u konsultuar paraprakisht me eprorin direkt dhe duhet të ketë gjithnjë parasysh ruajtjen e konfidencialitetit, brenda dhe jashtë institucionit.

6. Respektimi i parimit të konfidencialitetit është i detyrueshëm të zbatohet/respektohet përgjatë gjithë periudhës së punësimit dhe deri 2 vite pas përfundimit të saj.

## **Neni 10**

### **Parimi i eliminimit dhe shmangies së konfliktit të interesit**

1. Punonjësi i Komisionit duhet të kryejë detyrat në mënyrë të tillë që veprimtaria e tij të mos ndikohet nga interesat personale.
2. Punonjësi i Komisionit duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të identifikuar ato rrethana që mund ta përballin me një konflikt interesi dhe të veprojë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe rregullat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit, rregulloren e posaçme për parandalimin, shmangien dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave në ushtrimin e detyrave të tij funksionale, të miratuar për këtë qëllim nga mbledhja e Komisionit.

## **Neni 11**

### **Ushtrimi i veprimtarive të jashtme**

1. Ushtrimi i veprimtarive të jashtme, në çdo rast do të bëhet në përputhje me aktet nënligjore të dala në zbatim të rregullimit të fushës së veprimtarive të jashtme. Në çdo rast, punonjësi duhet të ndjekë procedurën e përcaktuar në aktet nënligjore dhe të marrë masa që kryerja e veprimtarive të jashtme të mos sjellë pengesa apo vonesa në kryerjen e funksionit që ai mbart.
2. Në asnjë rast kryerja e kësaj veprimtarie nuk duhet të cenojë integritetin, reputacionin dhe imazhin institucional të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe as të cenojë pavarësinë, dinjitetin dhe integritetin moral dhe profesional të punonjësit.

## **Neni 12**

### **Integriteti dhe korrektësia në nivel individual**

1. Punonjësi duhet të tregojë integritet të lartë moral dhe korrektësi gjatë orarit zyrtar, por dhe përtej këtij orari. Integriteti i punonjësve të Komisionit është një përgjegjësi personale dhe një detyrim pa kompromis për zbatimin e kërkesave ligjore, rregulloreve, vlerave morale dhe etike institucionale.
2. Punonjësit e Komisionit duhet të bëjnë kujdes dhe të ushtrojnë përgjegjësitë ligjore dhe kompetencat e tyre, në funksion të interesit të institucionit dhe të rritjes së besimit të publikut tek institucioni i KPK-së, në përputhje me misionin e parashikuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016. Për këtë qëllim, sjellja e çdo punonjësi të Komisionit duhet të jetë mbi çdo dyshim dhe qortim publik, duke vepruar me ndershmëri absolute në kryerjen e detyrës së tyre.
3. Punonjësi duhet të jetë i përkushtuar në kryerjen e detyrave të tij funksionale, zbatimin me korrektësi të orarit zyrtar, përdorimin e mjeteve të punës, posaçërisht në funksion të kryerjes së detyrave të tij, si dhe të marrë masa për një paraqitje etike në veshje.
4. Në asnjë rast, pavarësisht ngarkesës në punë, punonjësi nuk duhet të marrë dokumente zyrtare në shtëpi, ose jashtë ambienteve të zyrave.
5. Për një prezantim sa më dinjitoz të punonjësit dhe të institucionit që përfaqëson, punonjësit i ndalohen sjellje të papranueshme të cilat cenojnë imazhin e tij. Gjatë orarit zyrtar të punës punonjësit duhet të kenë veshje korrekte formale gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, takime pune në institucionet e tjera, dhe veçanërisht në seancat publike që zhvillon Komisioni në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të subjekteve të ligjit nr. 84/2016.

6. Kodi i veshjes në seancat publike është i detyrueshëm të jetë formal (xhakëtë/këmishë me mëngë të gjata dhe pantallona për punonjësit dhe xhakëtë/këmishë me mëngë të gjata, me pantallona/fund në gjatësi korrekte për punonjëset).

## **KREU II**

### **MARRËDHËNIET INSTITUCIONALE DHE NDËRINSTITUCIONALE**

#### **Neni 13**

##### **Marrëdhëniet epror - vartës dhe marrëdhëniet me kolegët**

1. Në ushtrim të kompetencave të tij, punonjësi duhet t'i përmbahet me korrektësi strukturës organizative sipas shkallës së hierarkisë të përcaktuar në të.
2. Punonjësi duhet të jetë i komunikueshëm me kolegët, të tregojë respekt ndaj tyre, pavarësisht shkallës së hierarkisë dhe të mos cenojë kolegët apo vartësit nga ana morale, etike dhe profesionale.
3. Punonjësi duhet të bashkëpunojë me kolegët dhe vartësit, në funksion të kryerjes së detyrave funksionale, të japë informacion të plotë dhe të saktë kur i kërkohet, dhe në asnjë rast të mos diktojë dhe të mos ushtrojë presion në vendimmarrjet e kolegëve dhe/ose të vartësve të tij.
4. Punonjësi duhet të karakterizohet nga etika e komunikimit, brenda dhe jashtë ambienteve të zyrave.

#### **Neni 14**

##### **Marrëdhëniet dhe komunikimi me subjektet e rivlerësimit**

1. Në çdo rast punonjësi duhet të respektojë dhe të zbatojë me korrektësi detyrimet ligjore në kryerjen e funksionit të tij në raport me subjektet e rivlerësimit.
2. Punonjësi duhet të sigurohet që kontrolli i të dhënave, verifikimi i tyre, mbledhja e informacionit, këqyrja e dokumenteve justifikuese dhe korrespondenca me institucionet e tjera të jetë në përputhje me qëllimin për të cilin kërkohet apo mblidhet ky informacion, dhe jo në tejkalim të tij.
3. Komunikimi, përjashtimisht vetëm për nevoja urgjente të punës, me subjektet e rivlerësimit, dhe vetëm në rastet e autorizuara nga eprori direkt dhe/ose titullari i Komisionit, bëhet vetëm në mënyrë të autorizuar nëpërmjet *e-mail*-it zyrtar të [kpk.al](http://kpk.al) ose telefonit të zyrës të vënë në dispozicion nga institucioni, në adresën/numrin e kontaktit të deklaruar zyrtarisht nga subjekti, për qëllim të procesit të rivlerësimit në formularin përkatës të plotësuar prej tij.

#### **Neni 15**

##### **Marrëdhëniet me institucionet publike, median, shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare**

1. Në marrëdhëniet e vendosura me institucionet publike në vendin tonë, me median, shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare, punonjësi duhet të marrë masa që, në asnjë rast, dhe për

asnjë arsye, komunikimi të mos jetë me iniciativë të tij, por me autorizim dhe aprovim paraprak të titullarit të Komisionit.

2. Punonjësi duhet të shmangë çdo lloj sjelljeje në publik që mund të interpretohet ose lidhet, në ndonjë mënyrë, me pozicionin e tij në institucion.

### **KREU III**

#### **MBIKËQYRJA E RESPEKTIMIT TË KODIT ETIK TË SJELLJES**

##### **Neni 16**

##### **Mbikëqyrja e Kodit Etik të Sjelljes**

1. Mbikëqyrja e respektimit të rregullave që parashikohen në këtë Kod Etik kryhet nga e njëjta strukturë e caktuar me urdhër të titullarit të Komisionit, si Autoriteti Përgjegjës në zbatim të rregullores për parandalimin dhe shmangien e konfliktit të interesit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

##### **Neni 17**

##### **Dispozita zbatuese**

1. Në rast veprimi/mosveprimi faktik të kryer nga punonjësit, me/ose pa dashje, pakujdesi a neglizhencë, në kundërshtim me këto rregulla, tërheqja e vëmendjes bëhet verbalisht nga struktura mbikëqyrëse dhe, në rast përsëritjeje brenda 1 viti, përbën shkak për fillimin e procedimit disiplinor ndaj punonjësit, këshilltarit ose punonjësit administrativ të Komisionit.

2. Dispozitat që rregullojnë elementet procedurale dhe materiale të shkeljes së këtij Kodi Etik Sjelljeje, parashikohen respektivisht në rregulloren për procedurat disiplinore për këshilltarët e njësisë së shërbimit ligjor dhe në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e administratës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

### **KREU**

#### **DISPOZITA TË FUNDIT**

##### **Neni 18**

##### **Hyrja në fuqi**

1. Ky Kod Etik Sjelljeje hyn në fuqi me miratimin e tij nga mbledhja e Komisionit dhe një kopje e tij u njoftohet dhe vihet në dispozicion punonjësve administrativë dhe këshilltarëve të njësisë së shërbimit ligjor të Komisionit, nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Komisionit.

2. Rregullat e parashikuara në këtë Kod janë objekt rishikimi dhe miratimi nga mbledhja e Komisionit, në përputhje me rregulloren për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Miratuar me vendimin nr.89, datë25.11. 2019 të mbledhjes së Komisionit.\_